



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*  
*Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,*  
*Technology and Innovation*

Datë: 29.09.2023  
Nr. 5-3458

Komisioni për licencimin e BPrAL / Kolegjeve Private, i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 protokol 3458 të datës 29.09.2023 të parashtruar nga BPrAL - Kolegji "UNIVERSUM" për licencimin e programit sipas vendimit nr. prot. 1202/23 i datës 15.09.2023 dhe mori këtë :

**V E N D I M**

1. Licencohet programi i studimit i Kolegjit Universum – kampusi kryesor në Prishtinë; Menaxhment MA 120 ECTS me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik i akredituar nga AKA sipas vendimit nr. prot. 1202/23 i datës 15.09.2023.
2. Periudha kohore e licencimit zgjatë nga tetor 2023 deri me 30 shtator 2026.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**A r s y e t i m**

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr.5 protokol 3458 të datës 29.09.2023 të parashtruar nga Kolegji "UNIVERSUM", vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë, zgjat tri vite akademike ( Tetor 2023 deri me 30 Shtator 2026) sipas vendimit Ref.1202/23 i datës 15.09.2023 të Agjencionit të Kosovës për Akreditim.

Komisioni për Licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Komisioni i ankesave të nëpunësve publik dhe ankesave tjera në MASHTI.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Parashtruesit të Kërkesës;
2. Komisionit për Licencim;
3. DALSHIT;
4. Inspektoratit të Arsimit;
5. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

  
Burim Gashi